KUVENDI KOMUNAL - DEÇAN

Municipal Assembly of Decan

TRANSKRIPTI

Mbledhja e Kuvendit të Komunës

(Legjislatura e VII , mbledhja e IV-të e rregullt)
me dt.30.04.2024

DEÇAN

E Martë 30 Prill 2024

Hajdar Sutaj

Kështu, nëse kam mundësi e me na tregua edhe gazetari kosovapress- it, kur jemi të gatshëm me fillu. I nderuar kryetar i komunës së Deçanit, zoti Bashkim Ramosaj. Të nderuar drejtorë të drejtorive. Të nderuar të respektuar kolegë, antar e antare te kuvendit të komunës. E hapi mbledhjen e 4-t të rregullt të kuvendit të komunës së Deçanit, ashtu siç edhe e keni marë materialin, për rend dite propozoj këtë rendë pune.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i raportit financiar për periudhën 01 Janar- 31 Mars 2024;
3. Ridestinim i mjeteve buxhetore nga Mallra dhe Shërbime në Subvencione;
4. Raporti i mbledhjes së parë të vitit 2024 të KKSB-së;
5. Propozim vendimi për hartimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Dhunen në Familje;
6. Të ndryshme.

Po ashtu Më lejoni t'ju pyes pastaj për disa pika shtesë, të cilat i propozojmë këtë mbledhje. E kemi dërguar një material, 2 ditë pasi që është ardh materiali i rregullt që bëhet fjalë për këmbimin e pronës, gjithësisht te ni rruge në fshatin Dashinoc, që është i njëjti pronarë, po ka figuru në mes toke edhe vetëm e ka ndru destinacionin që e kanë qitë pjesën anësore të pronës së vet.
Poashtu është plotësim ndryshimi i vendimit për caktimin e lokacionit për pishinën gjysmë olimpike ministria ka kërku ni dokument. Po plotësimi i dokumentit është vendim i janarit. Edhe, më lejoni që pastaj të të ndryshmet ti diskutojmë në 2 pika. Çë është sipas planit punës ni vizitë studimore në Gjirokastër. Dhe po ashtu të diskutojmë për agjentën me data 5 dhe 6 maj që në ditët të cilët Deçani nderon dëshmorët dhe martirët e komunës sonë. Nëse keni diçka për të thënë për rendin e ditës, Ju lus që ti thuni, e hapi si diskutimin, po zoti Orges Tafilaj e ka fjalën nëse ka mundësi regjia me ja kalu fjalën Orgesit.

Orges Tafilaj
Falemnderit kryesus përshëndetje për kolegët. Fillimisht nuk na ka ardh paradite plani për menaxhimin e fatkeqësive natyrore qysh është paraparë me plan punës. Arsyeja pse nuk ka ardhë kur pritet me ardhë, edhe pyetja tjetër është, ku jemi me procedurat për anëtarësimin ne unionin e bashkive e shqiptare? Falenderim.

Hajdar Sutaj
Falemnderit Orges, sa i përket planit për menaxhimin e mbeturinave e fatkeqësive realisht atëherë kisha kalu fjalën për arsyetimin pse nuk e kemi futur këtë takim? Si pikë e rendit të ditës te drejtori i shërbimeve publike Izet Zenuni. Nëse keni mundësi me e dhez mikrofonit te drejtori.

Drejtori, Izet Zenuni
Mirëmëngjes për të gjithë, mirmëngjes kryetar E arsyeja pse u shtye e plani për menaxhimin e fatkeqësive natyrore është se bazë një udhëzimi administrativ duhet të krijohet 1 grup I punës tu fillu prej asamblesë dhe drejtorive përkatëse. Mendoj se materialin për. Formimi i grupit punues edhe draft planin na është i gatshëm thuja po paraprakisht pa i ndjek procedurat nuk mundet me kalu si dokumenti i plotë mbledhjen e ardhshme të asamblesë vijnë propozimet për grupet, grupin punues edhe me fillu punën që ne muajin qershor me përfundue si dokument.

Hajdar Sutaj
Faleminderit drejtor, ndërsa sa i përket pyetjes për procedurat për anëtarësimin në unionin e bashkive shqiptare, meqenëse procedurat duhet të bëhen në emër të kryetarit, kryetari na ka dhën gjitha autorizimet që me fillua me këto procedura dhe besoj që pas datës 5 dhe 6 maj që i

përmbyllim domethonë ciklin e aktiviteteve të cilat i kemi dhe do ti fillojmë gjitha procedurat, ashtu siç kërkohet që të bëhen pjesë e këtij unioni. Falemnderit shumë dikush tjetër. Atëherë kolegë e qes në votim rendin e ditës kush është për, Falemnderit a ka kundër? A ka apstenim? Konstatoj që mënyrën anonime e kemi votuar rendin e ditës.

I. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi, e hapi diskutimin kushdo që ka diçka për të thënë në lidhje me këtë pikë, Orges Tafilaj.

Orges Tafilaj

Faleminderit kryesues, realisht fjalën e mora më shumë për të diskutu punën e transkripteve të 2 mbledhjeve paraprake. Jemi marrë vesh që të përmirësohen edhe ti votojme, ne skemi votu për to hiç. Kështu që kur kemi me votu, apo nuk do i votojmë fare , edhe pyetja tjetër eshte, meqenëse Dyka prap, duhet mu marr me procesverbalin, atëherë ku është arsyeshmëria që të kemi edhe transkriptim? Paguajmë transkriptim kot.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë e kemi zgjidhur këtë problem edhe në fund të muajit domethonë muajin që po hyjm do ti votojmë edhe ato transkripte dhe do ta kemi transkriptën ashtu siç duhet, për shkak se na është dasht me i rregullu me qenëse u kan si pervoj fillestare Disa gabime teknike, të cilat ata nuk kanë mujt për mi dhanë kuptim çdo fjalë, edhe pse gjuhësisht e kanë rregulluar por prap se prap pjesa mekanike duhet kapak një lloj përmirësimi dhe e kemi rregulluar prej këtij muaji. E dikush tjetër për procesverbalin. Atëherë e qes në votim procesverbalin e mbledhjes së kaluar kush është për. Falemnderit a ka kundër? A ka apstenim? Konstatoj që në mënyrën anonime e kemi votuar procesverbalin e mbledhjes së kaluar.

Jemi te pika 2- të

II.Shqyrtimi i raportit financiar për periudhën 01 janar-31 mars 2024 dhe fillimisht meqenëse kemi drejtoreshën prezente, e kisha lut drejtoreshën për buxhet dhe financa, Zonjën Dafina Cacaj, që ta merr fjalën dhe pastaj e kalojmë të shefat e grupeve dhe pastaj të anëtarëve të kuvendit Drejtoreshë, fjala për juve. e ndizni mikrofonin të foltorja. Me materialin bashkangjitur e keni raportin 3 mujor të shpenzimeve.

Drejtoresha, Dafina Cacaj

Këtë raport si qdo vit janë pagesat që janë bërë tremujorin e 1-rë, janë edhe obligimet e papaguara që kanë përfshirë 2 mujorin e fundit për shkaqe që nuk mundem me bo shpenzime në muajin e fundit e parafundit. Poashtu të bashkangjitje keni sot edhe 1 kërkesë që u kërku në KPF komisionet cilat jan paguar në tremujorin e 1-rë. Mirëpo cilat komisione jan pagu jau kam bashkangjitur edhe vendimet edhe pagesat e secilit anëtar të komisionit. Ka komisione që nuk janë vetëm prej asamblesë, jonë dhe komisionet të emërohen nga kryetari Dhe nëse keni pyetje në lidhje me shpenzimet, raporti është më ndryshe si herat tjera, për shkak se keni kërku me pasë të definume ose sa ka mallra qajo drejtori sa ka pagesa të derivateve, sa ka veç e veç për mos me pru tan ata qe kemi pru më herët jam bazuar edhe në komuna të tjera qysh e bin edhe mu ka dok që është zgjidhje më e mirë kjo që e kom pru un ksaj here, faleminderit

Hajdar Sutaj

Faleminderit drejtoreshë shef i grupit të AAk-s, Arjan Dobraj, e ka fjalën, pastaj kalojmë te Grupet tjera

Arjan Dobraj

Faleminderit kryesues i nderuar Sutaj, i nderuar kryetar i komunës së Deçanit, z.Bashkim Ramosaj, të nderuar anëtarë të ekzekutivit. Faleminderit drejtoreshës Zonja Dafina Cacaj për sqarimin në lidhje me raportin financiar tremujor, diçka që vrejtëm si grup është se qartësia e raportit, do të thotë shumë edhe më e detajzume. Në fakt gjë që na ra më shumë sy që do të thot nuk kemi diçka të

paqartë rreth përcaktimit apo ndarjes së pagesave sipas emërtimeve, do të thotë janë shumë të qarta, disa paqartësi të vogla që i pata realisht diskutum ma heret gjëra që i përmende edhe vet, për shkak se ka pas pagesa që janë kryer dhe do të thotë 2 muaj edhe për 2 muajt paraprak që gjithsej ka kap dikun 5 6 muaj me pagesa do të thotë, nuk kemi diçka të paqartë të falënderoj dhe një herë përsëri.

Hajdar Sutaj
Falëmnderës zotit Dobraj, në emër të grupit LDK- së, Albesa Cacaj e ka fjalën

Albesa Cacaj
Atëherë përshëndetje për të gjithë në emër të grupit të LDK- s ne jemi kundër kësaj forme të cilin është ardh raporti financiar për vitin për 3 mujorin e vitit 2024, raporti financiar është mekanizmi kryesor i monitorimit të buxhetit të komunës, përmes së cilit bëhet informimi mbi ecuritë dhe përmbushjen e planeve të grumbullimit të të hyrave dhe përmbushjes së obligimeve të planifikuara, si dhe mënyrat e shpenzimit të parave sipas natyrës së shpenzimeve dhe kategorive të caktuara buxhetore. Ky raport paraqet 1 raport që ka mungesë të detajuar të informatave financiare dhe rrjedhimisht mungesë të informatave të nevojshme për 1 vlerësim dhe gjykim të drejtë për adresimin e mangësive dhe përmirësimin e proceseve. Auditori i jashtëm për komunën e Deçanit ka dhënë vazhdimisht rekomandime që komuna të ndërmarrë veprime konkrete me qëllim që të reflektojë dhe të ofrojë sigurinë e nevojshme që paraja publike të shpenzohet në përputhje me planifikimin dhe qëllimin e synuar e jo që mjetet e destinuara nga kategoria e investimeve kapitale të përfundojnë te pagesat për vendimet gjyqësore dhe si pasojë e keqplanifikimit dhe keqmenaxhimit te buxhetit nga ekzekutivi komunal. Projektet kapitale, të cilat janë paraparë të fillojë për periudhën 2024, të mos përfundojnë brenda afatit dhe ato të cilat janë të planifikuara të mos fillojën fare, sepse buxheti i komunës së Deçanit për vitin 2024 është 12.660.517 euro. Prej tyre 2.536.000 janë ose janë paraparë investime Kapitale e që si dëshmi më të madhe se ky raport financiar e tregon se buxheti komunal është shpenzuar te pagesat për vendimet gjyqësore me shumën 2.223.287 euro. Furnizime për zyre për periudhën gjithmonë po flasin tremujore 68.950 euro. Shërbimet këshillënse 53.372 euro. Mirëmbajtje rutinore 43.000 euro shërbimet e veçanta 33.000 euro kompensim brenda vendit 32.000 shpenzime për udhëtime zyrtare, 14.607 euro derivate komuna për 3 mujor ka shpenzuar 9.879 mirëmbajtje e veturave zyrtare 8.000. Shpenzimet e varrimit gjithsej janë 20.279 euro, pastaj telefoni mobile, komuna e Deçanit me 1 buxhet të varfëruar ka shpenzuar 40.547 euro. Pajisje tjera të teknologjisë informative që duhen zemrën nuk di as çfarë saktëson është 34.000 euro, pastaj mirëmbajtje teknologjisë e 12.000 dhe shërbime kontraktuese tjera ky raport edhe 1 herë. E tregon avazin e vjetër të pushtetit. Pra buxheti vazhdon te shpenzohet buxheti i komunës së Deçanit vazhdon të shpenzohet përmes përmbaruesve Privat, me vendimet gjyqësore. Faleminderit.

Hajdar Sutaj
Faleminderit Albesa. Drejtoreshë, Ju keni të drejt me u përgjigj në fund ose masë qdo diskutusi, qysh do që e vlerësoni nëse lajmëroi për fjalë, fjala ju takon juve ose në fund. Prej grupit të vetëvendosjes, Faton Selmanaj.
Faton Selmanaj
Përshendetje kryesus, përshëndetje për të gjith Edhe ne si grup nuk pajtohem me këtë formë të raportit, sepse më shumë se gjysma e tij është Shpenzime të shkollave don me tha gjë që po të bon me nënkuptu që veq shkollat po bajn shpenzime Shumë mirë me kthy në formën, e cila ka qenë, unë pata veç një pyetje se spo du me qu ne diskutime hiq përderisa e keni pru në kët form kamufllazhi kështu për drejtoreshën se kur do të del në faqe forma cila ke deklaruar në mbledhje të komitetit për politikë dhe financa, sepse kam shikuar në faqe, ne faqe nuk është aty, ishin veç raporte vjetore me sa pash. Kështu që nëse priton me na sjell prap në at formë të paktën në faqe e ki obligim me publiku.

Hajdar Sutaj
Falemnderit Faton. Zotri Mon Selmanaj

Mon Selmanaj
Përshëndetje kryetar përshëndetje zoti kryesues. Të nderuar kolegë. Ky raport i shpenzimeve na ka ardh në 1 formë të re, me shumë pak të dhëna për mënyrën e shpenzimeve të buxhetit. Me përshkrime dhe emërtimet që ne nuk i kemi hasur në raportet e kaluara. Për shembull, subvencionet për entitetet publike dhe jopublike që kap shumën e 32.000 eurove, pastaj shtesa e veçantë për të zgjedhurit çka nënkuptojnë ato, në shumën prej 8.131 euro e disa përshkrime të tjera, për të cilat kërkojnë 1 elaborim më të hollësishëm nga drejtoresha e buxhetit. Kur jemi te zyra e kryetarit. I kemi shpenzime për telefoni mobile 37.287 euro. Nëse këto i përpjestojmë për 90 dit, atëher na del mesatarja që kryetari ka shpenzu telefoni 414 euro në ditë Si mund të shpjegohet kjo? I kemi vendimet gjyqësore. Vendimet gjyqësore i kemi në Total, 2.639.812 euro. Unë kisha pas dëshirë pak a shumë që drejtoresha me na elauburu pak ma thellësisht për këto shifra për këto shpenzime për këto, sepse shka nëse për 3 muaj buxhetit ju ka marrë 2.600.00 e kusur mijë euro, atëherë sa na mbetet ne më 9 muaj të tjer Investimet kapitale. Edhe sa po humb buxheti Kur e kemi trajtu buxhetin e vitit 2023, raport financiar për 2023. Ne kemi kërkuar që të deklaroni drejtoresh se sa kemi mbet dhe borxhet e papaguara vitin 2023, të cilat kanë me u bart atje dhe nuk ke marrë ndonjë përgjigje dhe përgjigjen tash po e shohim që për 3 muaj me vendime gjyqësore përmbaruesi na i ka marrë edhe 2.639.000 euro. Atëherë përshkrimi me kodet ekonomike 13 6 2 0 bie në sy 1 emërtim i ri furnizim me ushqim dhe pije, e jo dreka zyrtare. Furnizim me ushqim a mund të na shpjegoni pak më hollësisht se çka nënkupton furnizim me ushqim dhe pije? Ndërsa jo dreka zyrtare. Se ushqimi dhe dreka zyrtare, drekë zyrtare, shkon njeri edhe për Edhe për ushqim. Që kapin shumën ... shifrën prej 7.322 euro Nëse ju qëk ta 3 muaj i keni ndaluar drekat zyrtare, atëherë ju përgëzoj shumë dhe i mbështes dhe dëshiroj.

Hajdar Sutaj
Falemnderit Zotri Mon Dikush tjetër prej asamblistave. Blinera pastaj Syla. Blinera Loka e ka fjalën.

Blinera Lokaj
Gjatë shqyrtimit të raportit financiar ndër tjerash, vërejmë që është 1 raport i mangët në kuptimin e shkrimit strukturës kjartësis si dhe përmbajtjes që e ka. Disa nga gjetjet faktike në këtë raport janë para të shpenzuara për dreka zyrtare e të kamufluara nëpër kode të ndryshme. Pastaj ka kode te paqarta dhe të paspecifikuara. Për shembull kod,. Shërbime këshillëdhënëse dhe profesionale, pastaj kodi shërbime kontraktore si dhe shërbime të veçanta dhe kontraktorë individualë. Cili është dallimi në mes të këtyre shërbimeve? Apo kodeve, të cilat në total buxhetit komunal i kanë kushtuar plot 92.000 euro dhe duke u bazuar në këtë raport, ne nuk mund ta dimë sa është pagesa e borxhit të vitit të kaluar apo është tremujorin e parë

Hajdar Sutaj
Faleminderit kolegë Syl Balaj e ka fjalën.

Sylë Balaj
Shpenzimi shkollav Isa Boletini ku thot mirmbajtja e mobilieve dhe pajisjeve 1115 Euro këtu a hyn vendosja e kamerave mirmbajta e kamerave, apo qfar, e kam të pa qart vetëm lexon pajisjet e tjera 1.338 euro, a kanë ardhur pajisje të reja në shkoll Pajisjet e reja në shkollë llaptopa apo diqka se ne dijeni ton ska ardh as nje pajisje e re këta 3 muaj

Hajdar Sutaj
Falemnderit Sylë, Vatan Istrefaj

Vatan Istrefaj
Faleminderit Kryesus, përshëndetje për gjithë, Sa i përket raportit financiar, pra shifet qart keqmenaxhimi edhe kësaj radhe, por për të mos u zgjatur në diskutim dhe për të mos i cekur të gjitha. Nëse i duket kryetarit që është menaxhim i mirë le të qesh pra. Po shoh e kam paqartësi te telefonia mobile që është afro 40.000 euro shpenzime rreth këtyre 3 muajve. Kërkoj sqarim nga kryetari, pra se qysh erdh gjithë kjo shumë për vetëm 1 periudhë kaq të shkurt. Po ashtu sa i përket sa i përket keqpërdorimeve, po shihet qartë. Edhe qytetarët e kanë kuptuar ku shihet se vetëm përmbaruesi 2 milion dhe atëherë çfarë do të ndodh në pjesën tjetër të investimeve kapitale, por që kemi komunën kur përmbaruesi ti merr për 3 muaj 2.300.000 tash spo jom i sakt në shifër. Po ashtu sa i përket edhe shëndetit primar që e kemi këtu në Deqan Shifet që edhe këtu nuk kemi shpëtuar pa përmbarues. Ku e shohim që për këtë periudhë janë dikund afro 29.000 euro, Vetëm vendime gjyqësore e si pasojë e kësaj keqmenaxhimi, pra kemi mungesë të barnave esenciale në vazhdimësi e për një kohë të caktuar kemi pasur mungesë të shiringave, faleminderit.

Hajdar Sutaj
Faleminderit Veton, Miftar Ahmetxhekaj e ka fjalën

Miftar Ahmetxhekaj
Përshendetje Kryetar, pa dasht me u nal në ato që i diskutuan kolegët në formën e të shkruarit në ndryshimet e kualifikimet që po du me besu qe mund ta keni 1 sugjerim nga ministria e financave, edhe pse ka paqartësi. Po e them dhe po e ritheksoj, Buxheti i komunës do të duhej të ishte akti ose norma më e rëndësishme për vlersimin tim, referuar këtyre tabelave per mendimin tim kryetari dhe drejtoresha për financa nuk e ka ket vlersim, kët e bazoj në dy parallogaritje shumë të thjeshta Planifikimi buxhetor për vitin 2024 është 12 pikë diçka million. Nëse i referohem tabelës së ofruar shpenzimet për tremujorin e 1-rë, i keni 5 diçka milion. Nëse këtë kthej në përqindje i bie dikund afër 40% përqind të buxhetit e keni shpenzuar për 3 mujorin e parë Nëse e bëjmë edhe ni kalkulim të thjeshtë tremujorin me 12-të mujor i bjen qe për 25 për qind të kohës të vitit kalendarik. Ju keni shpenzuar dikund përafërsisht 40% përqind të buxhetit. Nëse i kthehemi seancës së fundit kryetari i nderum kur unë ju kam pyetur sa është borxhi në momentin që po flasim, edhe pse kjo nuk është evidentume përgjigjja juaj ne procesverbal. Përgjigja ka qenë 180.000 euro. Unë jam kon i vetëdijshëm se pos që është e pa sinqertë është edhe pa sakt si pergjigje. Nese i kalkulojmë shifrat 2 pikë diçka milion vendimet gjyqësore, po du me ta hjek ni katërqind mijshte të arsimit kontratave kolektive, megjithëse po du me vlerësu që nuk është faturë e juaj. Kjo i bie nëse ju i paguani çdo tremujor ka 1.8 fundi i vitit. Fundi do të jetë diku përafërsisht 8milion. Pyetja ime konkret edhe në këtë seancë është kryetar i nderum sa është borxhi në momentin që po flasim i komunës të Deçanit, nëse ju prap do më jepni një përgjigje, të pasakt dhe të pa sinqertë këtë do ta kuptojmë pas 3 mujorshit tjetë,r faleminderit shumë

Hajdar Sutaj
Faleminderit Miftar, dikush tjetër, Orges Tafilaj e ka fjalën.

Orges Tafilaj
Faleminderit kryesues, realisht, sa herë që e kemi diskutu për raportin financiar, unë kam qenë idhtarë i formimit të këtyre tabelave përmbledhëse po them. Megjithatë besoj drejtoreshë kryetar kishin qenë shumë ma mirë kësaj tabele përmbledhëse ti është bashkangjit edhe raporti i detajuar. Realisht nuk ndashta me e marr fjalën por për shkak të pyetjeve që bëjnë kolegët. Besoj raporti i detajuar i kish jep përgjigje gjith secilit, sidomos te ajo pjesa e faturave utilitare. Unë jam i bindun që ato mjete nuk jan hargjuar në 3 mujor, por jan pagesat viteve paraprake. Kështu që është mirë

tashmë me qenë se the për sot. Do bashkangjitet aty edhe me i pa detajume edhe e besoj ka me na jep pergjigje per secilin ze qe biseduam.

Hajdar Sutaj
Falemnderit Orges, dikush tjetër. Drejtoresha për buxhet dhe financa e ka fjalën, Dafina Cacaj.

Dafina Cacaj
Raporti e thash që publikohet sod, e kam prit asamblen, edhe te obligimet e papaguara kan qenë te publikume në fillim të vitit, komplet borxhi i vitit të kaluar, sa janë obligimet e papaguara se edhe ato e kemi obligim me publiku Te ushqimet dhe pijet. Ushqime dhe pije jo dreka zyrtare nënkuptojnë pijet që paguhen n'bife që i marrim edhe ushqimet që merren te shpia rezidenciale për personat që jetojnë atje nuk mundem me shkru ata drekt zyrtar se nuk është drekt zyrtarësh, por është furnizim me ushqim dhe pije për ata. Edhe për kërkesat tona nëse kemi. Telefonia, është pagese, që unë nuk kam mundur me bo 2 vjet e fundit hiqë, për këtë arsye është 40.000 mij, telekomi deri tash nuk më ka bër presion dhe ata qe nuk me bejn presion nuk ju jepi perparsi I kam paguar menjëherë që ka dal buxheti komplet faturën e 2 viteve për këtë duket pak ma e madhe se që duhet me kanë, I kam paguar një pjesë, nuk mujta me i pagu te gjitha, edhe i kom paguar momentin që e kam pas buxhetin. Dallimet mes kodeve vlerësim, sikur është, Shërbime kontraktuale ose shërbime. Individuale, perfshihen komisionet, përfshihen shërbimet e ndryshme që bën që u bë vlerësimi i pronave, paguhen me të njëjtin kod. Kontratat në vepra dhe shërbime tjera kontraktuale që kemi pas gjatë vitit të kaluar ose që jan mbart me kontrata deri në këtë vit. E mobilje dhe pajisje tjera qe e pate shembull në Isniq është pajisja e kamerave në shkollën e Lëbushës, për këtë arsye dyqan ti munesh mem ndihmu ma shumë për arsim. Une e di që ajo pagesë është për këtë arsye se Lëbusha është dege e Isa Boletinit ne Isniq, Po. Edhe te plani kontabël edhe ni herë po lidh te kodet, jon kode që na duhet me u përshta,t unë mundem me jau sjell edhe emailin që e kemi pas ftesën, jemi shkue zyrtaret e financave, e kanë mbajtë trajnimin me ministrinë e financave për ndryshimet që iu bënë fundvit në fuqi nuk u hi deri këtë vit edhe jon kode që na duhet më përshtat Edhe nese najher ndoshta nuk i përafrohet sikur është mobilje dhe pajisje tjera, osht kod i përbashkët për krejt ato. Pagesat që bëhen të asaj natyre edhe nuk e kemi bo na, na vetëm përshtatemi asaj që na kanë pru prej nivelit qendror.

Hajdar Sutaj
Faleminderit drejtoreshë. I. Faleminderit per sqarimet dikush tjetër prej atyne që s'kanë diskutu nuk është lajmëru. Atëherë ne e kalojmë si pikë të rendit të ditës dhe jemi në pikën e 3-të.

II. Ridestinimi i mjeteve buxhetore nga mallra dhe shërbime në subvencione.

Pra lus drejtoreshën për buxhet dhe financa znj Dafina Cacaj që të na jap sqarimet e nevojshme në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës dhe pastaj hapim diskutimin. Drejtoresh është fjala për juve.

Drejtoresha, Dafina Cacaj
Për shkak se të hyrat e bartura nuk barten me vendim të asamblesë, nëse nuk kemi tejkalim me ligjë të buxhetit osht fjala për këtë vit që është i votuar mundet në vitin tjetër me ndryshu me ardh apet. Por për kët vit vetëm nëse komunat kanë tejkalim të mjeteve të planifikuara, të risjellin në asamble Unë nuk e kem pas tejkalume planin e planifikume dhe nuk e kom sjell në asamble Mjetet janë aloku në ato kodet që kan qenë të planifikume vjetë dhe ka pas hapësirë që kanë qen të paplotësuara ne mallra, shërbime, kom pasë, hapësirë më të madhe. Këto kode janë planifiku janë aluku, mjetet po na 50-të mijë euro. Po kërkojmë prej qati kodit mallra shërbime me i transferu në subvencione për borxhin që ia kemi ndërmarrjes publike Higjiena, që u votu vjet në asamble. Unë jam zotu që nuk kam mjete po apet u votue dhe nuk kam mundur ta paguaj deri tash, tash po du me e pagu bile borqin e vitit te kalur që mos me mbet obligim I vazhdueshëm, nuk kam pasur mjete më shumë. kërkoj falje mallra për me mujt me kry obligimin deri në ditën e sodit. Po vetëm të vitit të kaluar.

Hajdar Sutaj
Faleminderit shumë drejtoreshë në emer te grupit AAK-s Yllarta Thaqi ka kërkuar fjalën Apo në emër të grupit. në emër të AAK-s.

Yllarta Thaqi
Sa i përket 50 mije eurove dashta pak me u ndërlidhë me këto, se vitin e kalum kur e kemi votu unë e kam abstenuar, për arsye se më është dukur tarifa shumë e lartë për qytetarët, ndërsa i ka mbet barr 85 centë komunës së Deçanit. Mbasi është edhe kryetari Këtu na votojnë për shkak se higjiena është 1 shembull më i mirë i komunës Deçanit. Deshta me e pyet deri kur ka me vazhdu ky 85 cent për me mbet mbarë komunës së deçanit, apo sepse këtu shkruhet deri në 1 vendim të ri. Jemi pro kësaj se higjiena është 1 ndërmarrje e cila na ka bo me u ndi mirë të gjithëve është shembulli i suksesit është shembulli i mirëmbajtjes, qytetit dhe fshatrave, por mos është ngarkesë për komunën e deçanit 85 cent, ndërsa nëse tarifohet ekonomive familjare, është barrë shum e madhe se asnjë komunë nuk e ka 6.85 cent Falemnderit shum Yllartë, Miftar Ahmetxhekaj nga LDK-ja .

Miftar Ahmetxhekaj
Përshëndetje dhe një herë kryetar më kujtohet mirë dhe kështu besoj se nuk më tradhton memorja kur e kemi aprovu këtë rregullore si grup kemi pasur atëherë dilemat dhe realisht kemi qenë kundër për 2 arsye, e 1-ra për vlerësimin tonë ka qenë 1 barrë për qytetarin. Domethënë, është rritur një tarif që unë po mendoj se as qytetet e kosovës më të urbanizume nuk e kanë këtë tarifë. Dhe e 2-ta për vlerësimin tonë ka qenë plus 1 barrë për komunën e deçanit dhe më kujtohet mirë dhe saktë që kur i kam shtru pyetjet qysh keni me i ngjit emrin. Këtij çmimi kësaj tarife dhe ju nuk keni pas ni përgjigje të sakt dhe tash na del që po dashkan në subvencione. Unë kryetar i nderum aq sa kuptoj dhe aq sa di subvencionet Janë para të cilat japin organizatat buxhetore për individët apo në institucionet për rimëkëmbje, për të vazhduar ne veprimtari për 1 kohë të caktuar. Unë nuk kom dëgju në jetën time në përvojën time që subvencioni lahet për borxh osht gabim Dhe këtu ju bëj thirrje që këtë rregullore me ndryshu këtë tarifë me hjek. Për 2 arsye e para me e lehtësu qytetarin dhe e 2-ta me ju lehtësu juve ish dash dhe do duhej higjienia të rimëkëmbet higjiena ta baj vetveten ju i keni dhënë aksione duhet ta dini u jam përsërit shumë herë në raport me këtë temë edhe frigohem qe ma marin pak për të keq absolut nuk kam asgjë subjektive, jam shumë objektiv në këtë situat është gabim me subvencion. Me subvencion paguhet borç është gabim edhe per ket gabim, ne jemi kundër dhe nuk e mbështesin këtë.

Hajdar Sutaj
Falemnderit shumë prej grupit vetëvendosjes. Orges Tafilaj e ka fjalën

Orges Tafilaj
Faleminderit Kryesues. Realisht unë prita që para anëtarëve para shefav grupeve parlamentare Anëtarët e kuvendit që marin fjalën në emër të grupeve me diskutu anëtarët e komisionit e komisionit të aksionarëve të ndërmarrjes. Megjithatë na jemi para 1 akti të kryer, 1 vendimi që kena mar si kuvend. Edhe nuk kemi rrugë tjetër pos me votu per sot. Megjithaë drejtoreshën dhe një këshillë miqësisht. Të lutem ku referohesh te pagesat, mos thuaj unë i paguajë se paguhet nga taksat e qytetarëve, paguhen nga gjithë ne këtu, kështu që mos i personalizo gjerat. Faleminderit.

Hajdar Sutaj
Falemnderit shumë Orges, Mon Selmanaj e ka fjalën.

Mon Selmenaj
Faleminderit kryesues. Atëhere Mendoj që Pak a shumë duhet të debatohet dhe trajtohet mënyra se si është ardh deri te, Deri këtu që mjetet Jo të planifikuara. Për 1 shumë 0.85 në të cilën e ka

kërkuar kryetar i komunës në mbledhjen e vitit të kaluar, në mënyrë që. të përmbushet apo të ndahet pjesërisht kërkesa ndërmarrjes publike lokale higjiena në amvisri prej 6 euro dhe 0.85 cent i mbetet barrë Komunës këtë barrë vet. Ekzekutivi komunal e ka kërku dhe mazhoranca. Që sot po thotë e ka miratu. unë në diskutimin e tij e ka mbështet fillimisht vitin e kaluar ndërmarrjen higjiena dhe kërkesën e saj. Mirëpo. Jam qenë kundër që të ngarkohet komuna me 0,85cent sepse diku 60.000 e llogaritsha që do të. Jetë buxheti. Apo shuma përcillen duhet paguar kompania për punët e kryera dhe kur nuk ke mjete të planifikuar, unë e kom ditë, atëherë kom ditë që ne kemi me ardh në 1 situatë që 14 muaj pas. Të mos paguhet për punën e kryer ndërmarrja higjena, ndërsa e pyes drejtoreshën për vitin e ardhshëm se si do t'ia bëni për vitin e ardhshëm, kur prapë do të vazhdojmë me pagesat 0,85cent ndërsa nuk keni mjete të planifikuara, si mendoni që këtë vit TI kryeni obligimet ndaj kësaj ndërmarrje? Ju falemnderit.

Hajdar Sutaj
Falemderit zotri Man dikush tjetër. Faton Istrefaj e ka fjalën.

Vatan Istrefaj
Duhet me pas dhe një sqarim shtesë e shoh se tek fakturat që ka sjell per higjiena pra totali i fakturës është 30.000 mijë euro Atëherë pse po kërkohen 50.000 mijë euro që të bëhet ridestinimi i tyre? 20.000 euro plus tregon për çfarë arsye është kjo shtesë.

Hajdar Sutaj
Falemnderit shumë dikush tjetër. Arjan Dobraj.

Arjan Dobraj
Faleminderit kryesus. Në fakt ne e dimë se ndërmarrja higjiena është krijuar prej asamblesë prej asamblesë kaluar, kështu që nuk nuk po e shoh pse është kaq problematike me përkrahë. Për me ec ose për mbarëvajtjen e kompanisë kur opozita po folin për mbarëvajtje, këta në fakt po e kundërshtojnë mbarëvajtjen e kësaj kompanie. Edhe nuk. Nuk po e shoh çka ka telashe me me përkrahë çfarëdo lloj forme që na krijohet mundësia më e përkrah. Dikur. Jo. Tha dikush nga opozita që është vlera 30.000 mijë ju nëse bëhet fjalë për 9 muajt e 1-rë të vitit kaluar është 38.000, që i bjen edhe 12.000 për 3 muajt e fundit. Atëher bohet 50.000 domethanë Nuk ka telashe nga ana matematikore, thënë kështu. Falemnderit.

Hajdar Sutaj, E ka fjalen Faton Selmanaj

Faton Selmanaj
Faleminderit kryesues. Kolega Arian iu drejtua opozitës, opozita e ka për obligim me kërku llogari. Ndërmarja higjiena po bohen rreth 4 vite nese nuk gaboj qe osht e themelume Dhe ndërmarjen higjiena osht duke e mbajtur realisht komuna çdo vit i kemi do me mijëra mijëra euro herë 300.000 herë 200.000 vitin e kalum për kontratën jan ndarë 800.000 euro. Në vazhdimësi ne askpektin financiar është tu e mbajt komuna gjë që ndërmarrja osht dasht me i marr hapat e vet Dhe me pas ni stabilitet dhe një qëndrueshmëri të veten pa u varur shumë prej komunës gjë që nuk është duke ndodhur Tjetra qe dashta me than osht qe kjo barrë buxhetore Dhe në vitin e kalum me 1 kërkesë të kryetarit të komunës ka qenë puro politike. Sepse ka qenë shumë më mirë se kryetarit të ishte realist. Dhe të tregonte të vërtetën mbi ndërmarrjet publike. Problemet financiare që ju kanë faturu Ndërmarrjeve në përgjithësi, sepse është shtrajtuar deponit zbrazi është shtrajtu është 1 plan i ri shtetër i cili pritet Dhe mbi të gjitha ka ndodhe dhe një inflacion i përgjithshëm, gjë që ka rritur vlerën e përgjithshme, kështu qe nje pytje pata krejt për fund gjë që e kam ba edhe në komisioni për

politikë dhe financa po e bëri dhe kolegja. Në këtë dokument thuhet se kjo mënyrë e pagesës do të vlen deri në 1 vendim tjetër të kuvendit dhe sa mendon kryetar që ky vendim të jetë në fuqi

Hajdar Sutaj
Falemnderit Faton dikush tjetër prej atyre që nuk kan diskutu Syl Balaj.

Sylë Balaj
Pershendetje per te gjith edhe un jam kunder kësaj mënyre pagese nga subvencionet, më mir subvencionet ti përdorin bërë diçka tjetër kur kem gjendjen e Shumë klubeve sportive se është e mjerushme më mir ti ndihmojm ata se sa të paguajm borxhe.

Hajdar Sutaj
Falemnderit shum Arjan tu ka përmendur emri ki drejt 1 minutë replikë, edhe pse është dashur ti me kerkue

Arjan Dobraj
Kam komuniku me ni koleg prej kuvendit komunal në Gjakovë edhe ne nuk mundem me u tregu ma të meqem se komuna tjera sapo më tha që edhe komuna shpesh e përkrah domethonë kompaninë çabrati me mjete financiare. Çfarëdolloj forme domethën nëse pret ky për 4 vjet na me ec me kamb tona atëher është pak e vështirë kurkur e përkrah komuna e pejes komuna e gjakovës, atëher pse ne me u tregu më te menqur, falemnderit.

Hajdar Sutaj
Nuk tu ka permend emri. Kryetari e ka fjalën kryetari Bashkim Ramosaj. Kryetari Bashkim Ramosaj e ka fjalën. E kjart e kjart E kryetari Bashkim Ramosaj e ka fjalen

Kryetari, Bashkim Ramosaj
Përshëndetje për të gjithë. po mundohem me qen gjitheperfshires në këtë Dilemën që u hap ose Kërkesat që u bën rreth ndërmarrjes higjiena. E rëndësishme është që pom vjen mir qe e kem nje qytet te paster E 2-ta po ashtu ndihem mirë sepse ndoshta e vetmja komunë në Kosovë që kem ndërmarrje komunale e cila merret me ambient. E 3-ta që duhet me qenë objektive, krejt neve osht që me bo qmos që këtë ndërmarrje me maturu edhe ma teper Maturimi i ksaj ndërmarrje ka me ndodh ku ka me kriju produkte të tjera shtesë. A jemi në kohë kur këto Produktet duhet me hy në funksion. Unë besoj që jemi, mirë po e a kemi luksin dhe a kemi krijuar standard për me qën kështu nuk e besoj qe jemi e shikoni qe komplet brenda shtetit tonë nëpër krejt teritorin e Republikes së Kosoves Pamja më e shëmtuar është bërllogu Dhe. Nuk duhet me lën gjë pa bë qe mos me pas berllog A duhet me nxjerr një vendim tjetër që e pezullon këtë vendim? pe bojm një vlersim në rast se nuk ja komplikojmë jetën ndërmarrjes dhe mundemi me i ngarku qytetart me kit taks Ose mundemi me largu krejt. le të bëhet një vlerësim le të bëhet një diskutim osht komisioni i aksionarëve bordi drejtues mundet me bo ni ekspertizë. Unë ju kisha than. me mbështet për shkak se. Osht ni strategji nacionale e cila. Nuk hyn në funksion kurrë dhe unë nuk pres as nuk ka me hy në funksion. Për shkak. Shumë komplikime që po ndodh në këtë pjesë, mirëpo kur do që ndodh, është mirë që na me qen me standardin e duhur. A duhet me pas produkte të kompostimit? Po a duhet me postë produkt të ndarjes në burim mbeturina po a duhet me pas riciklim po a duhet me pos grumbullim mbeturinave inerte riciklim tyne edhe po a duhet me pas 1 automjet transporti që shkon vetëm 1 herë në deponinë rajonale po dhe krejt këto janë kosto? A duhet në pas një ekip e cila shkon nëpër nëpër bjeshk tona për të mbledhur mbeturina? Unë besoj që po a duhet më pas automjeti i cili bën transportin e? Automjetet që parkohen pa leje nëpër trotuar ish dasht edhe kët shërbim me pas, dhe këto nuk bëhen pa e pasur një buxhet Këtu nuk bëhen pa e patur një mirqënje

Unë. Unë qysh do që ta vlerësoni ju kurdo që ta Vlerësoni ju na mundën me diskutu, mirëpo ju kisha ftu të gjithë juve. S'paku shefat e grupeve le ta takojn komisionin e aksionerëve le ta bëjnë ekspertizën le ta bëjn 1 studim dhe ta bini ni përfundim ta bini ni propozim, mirëpo ideja ime është mos me kursye që sa i përket ambient. Dhe. do tema te mdhaja duhet të kryejmë me kalu ni start krejt tjetër si komunë? perndryshe kemi me mbet gjithmonë ne ket rrethin vicioz tu u sjell. Me krejt respektin e perjuve mu mduhet me u largu per një or nga seanca për shkak se kom. Ekipin kombëtar të kërkim shpëtimit këtu dhe e kam themeluar njësi të kërkim shpëtimit malor. e i kam lë në pritje Po kërkoj me mirësjelljes që mem fal pak.

Hajdar Sutaj
Kryetar faleminderit takohum, pastaj vazhdojmë kështu. Koleg jemi larguar pak nga rendi dites, sepse nuk jemi tu diskutuar për mjetet financiare ni pjesë ku jemi tu diskutu për vendimin. Na e kemi me plan të punës domethonë edhe raportin e higjiens atëher mundemi me diskutue ma konkretisht çka duhet për me ndërmar. Poju thonë sinqerisht mundemi pyet gjitha komunat përreth, filloni prej Pejës prej Gjakovës prej Kline prej Istogut prej Prishtinës për çmimet saj i kanë Albesa Cacaj e ka fjalën.

Albesa Cacaj
Fillimisht dua te pajtohem me deklarimin ose konstatimin e kryetarit qe e deklaroj më parë E kam 1 pyetje teper të thjesht se siqnerisht nuk kuptoj me 22 dhjetor 2022 osht ardh ne asamble Kërkesë nga ekzekutivi që të bëhet kjo rritje prej 0.85 cent, edhe pse edhe njëherë peritheksoi që ne si grup parlamentar ldk-s skemi qenë kundër, por edhe drejtoresha në fjalë edhe atëherë edhe sot deklaroi se komuna ose drejtoria për buxhet nuk ka buxhet mjaftueshëm për të mbuluar kët kategori ose kët shpenzim. Atëherë pse është ardh ne asamble meqë nuk e keni bërë planifikimin e mirëfillt me fillim edhe mos me ardh te situata ne te cilen jemi sod që nga Kategoria e subvencioneve dhe mallrave të shkojnë te shlyerja e borxheve në vend që të shkojnë në ndonjë investim kapital ose te subvencionet që bëhen me Shpallje publike në bazë të kritereve fiton ai qe i permbush. Faleminderit.

Hajdar Sutaj
Kolege sa për me e rikujtue se na mundën iu referuar procesverbalit për me qën më të sakt. Kërkesa nuk ka qenë prej egzekutivit që ne ti ndajm 0.85cent si komun. Kërkesa ka qenë prej ndërmarrjes higjiena që me qenë çmimi 6.85 mandej ne kemi pasur 1 propozim prej grupit të aak-s në atë kohë që 6 mbet tarifa prej që ngarkohen ekonomitë familjare dhe 85 cent mu ngarku komuna në mënyr që te lehtohet ajo Edhe domethonë na kemi aprovu çmimin për 6.85 momentin që na çfuqizojm këtë 0.85centsh ajo ngarkohet tek Qytetarët. 6.85 Domethonë kaq ishte sapër sqarim Leotrim Hadergjonaj e ka fjalen Jo i fal. Ok. Miftari 1 minutë e ka

Miftar Ahmetxhekaj
Faleminderit shumë kryesues. Nëse i referohem ligjit për ndërmarrjet publike, nëse nuk gaboj neni 5 në momentin që komunat ose aksioneri e themelon 1 ndërmarrje publike, nuk ka detyrim financiar, ndërsa. nëse është më ndryshe. Ma thuani neni 5 i ligjit për ndërmarrjet publike sa i përket subvencionit edhe 1 herë subvencionet zakonisht jepen momentin kur palet konkurrojnë kryesues i nderum dhe konkurrojnë mbi bazën e kritereve që organizatat buxhetore i vendosi le të konkuron higjiena me organizatat e tjera me ndërmarrje tjera, me kompani me individ dhe i vendosi kriteret e merr subvencionit. Është e pakuptueshme borxh për subvencion, kaq.

Hajdar Sutaj
Faleminderit Leutrim Hadergjonaj e ka fjalen

Leotrim Hadergjonaj

Përshëndetje për të gjithë. Kisha pas ni kërkesë drejtuar për kompaninë higjiena po shoh që nuk ka ardhur askush nga ata që seancën e ardhshëm të asamblesë me na sjell një raporti te detajizuar financiar të vitit 2023. Përderisa ne jemi, ne jemi aksionari kryesor i kompanisë higjiena, kompania është pronë komunale. Është mirë me na sjell një raport analitik detajizuar financiar 2023 për pagat, shpenzimet, blerjet. Sepse ne atëherë kur kam votu ket raport për mjau çitë 0.85 cent ka qenë koha, rritjeve t`mdhaja çmimeve që ka qenë karburanti 1.90cent tash ka ra 1.30cent Ne kompanisë higjiena ju ndihmoj deri 300.000 në vit 10 prej kontratës asht kan mirë me pru një raport detajizume dhe me pa a kanë nevojë kompania higjiena për këto 50.000 mij euro te komunës Që na tek e fundit prapë jemi t i ndihmu çdo vit është mirë natura, sepse edhe këtë herë po e kalojmë, por herën tjetër nuk kalon qoftë se nuk e kemi 1 raport detajizuar financiar dhe ndryshojnë komplet që udhëzim administrativ

Hajdar Sutaj
Falemnderit Leotrim, drejtori i shërbimeve publike Izet Zenuni e ka fjalën e pastaj Florim Mataj Florimi e ka fjalën pastaj e përmbyll drejtori.

Florim Mataj
Përshëndetje kryesues, përshndetje drejtora koleg kolege dashta me u kyç pak në lidhje me vendimin qe e kem marr osht e vertet qe u tha ne at koh kur na ka ardh aj vendim rritje enorma kan qe qmimet Ky vendim ka qenë. Diçka që po e shoh që po ngatërrohet nga shumica nga ne. Me kontraten shtëpi ne nuk i ndihmojm higjienes duhet ta kemi te kjart ajo kryn shërbim per komunen qe mos me kry ajo e kryn dikush tjeter e në subvencionet tjera kur i kemi nda e kom subvencionu higjienen Po. Vendimi që e keni mar në atë kohë ka qenë 0.85 cente kemi bart si komune me mbulu me ni periudhë. Shkurt. Higjena ishkon mir me ardhme me 1 raport nëse nuk është i nevojshëm këtë 0.85 cent me inkasuar prej komunës, cila është arsyeja që me ja dhanë na higjienes dhe ajo që kisha kërkuar më shumë që higjiena duhet të na paraqitni planprogram brenda periudhe 10 vjeqar vjeçare ku do me shku ajo ndërmarje dhe cili eshte cili është efekti i saj dhe qëllimi ku ka mbërri dhe kur do fillojë që t'ia kthejë aksionerit kryesor. Në këtë rast komuna e deçanit ia ktheu dinjitetin. Normal komuna e ka obligim se e ka themelu osht aksionar 100% në momentin kur kompania ka me dalë me fitime ka me u rykthy te komuna, kështu që këtë deshta me e ngrit dhe eci fjali ndihmesë për kontratën e shërbimit që ai bën, nuk e kisha qujt ndihmes realisht nuk është ndihmes se ka kry shërbime. Edhe një her leutrim ta ndajmë se ti e din qe je biznizmen mos me bo higjiena ket pun vjen ti me kompaninë tone e bën kështu që ta bëjmë dallimin ta bëjnë dallimin kur të afrohet shërbimin dikush dhe subvencionin pagën që ia paguan këtu që të jemi realistë koleg Se di sa e di askush, është mirë që ta ndajëm

Hajdar Sutaj
Falemnderit Florim realisht para se me kalu fjalën drejtorit deshta me thon qe na kane dhe plan pune raportin e higjienës. Nuk e di a kem në maj a qershor, por shikojmë edhe, Ok drejtori Zenuni e ka fjalën.

Izet Zenuni
Faleminderit kryesus Paraprakisht para se me ardhë vendimin në asamble me propozim të kryetarit Për ngritjen e tarifës do të thotë, ka qenë 4,75. ne atë periudh kur ka ardh si propozim 6..85 Duhet ta kemi të qartë 0.85 cent nuk është duke ju dhën higjienes ne ate kohë ku në periudhë por është per ti subvencionuar qytetarët që mos me u ngarku 6.85 ta kemi të qartë nuk osht borq qe jem ka e lajm tek kompania po është nda tarifa prej 6.85 në 6 euro që 0.85centin me bart komuna mos me bart Qytetari Është vendim osht procesverbali është i qartë dhe propozimit që ka qenë prej asamble. Te pjesa tjetër te kontrata shtëpi osht temë që tha edhe florimi jemi tu e perzi 8 operatorë privatë nat periudhë pa u formu kompania higjiena i kanë kryer shërbimet që kryen sod higjiena dotethot eshte pun qe kryen higjiena E edhe paguhet prej kontrates do të thotë tash e ka te zgjerume

Orges na kemi rrug. te emertume tmiratume ketu n'kuvend dhe nuk janë të pajisura me tabela a ka mundsi me dite, Kur pajisen.

Hajdar Sutaj
Megjithatë e ka adresu pyetjen Orges fjala për juve.

Orges Tafilaj
Faleminderit Erdogan realisht ne jemi vetëm për emërtime, dhe riemërtime pas vitit 2029, ku lejohet edhe jemi përball me këto probleme dhe gjatë vizitave në terren.

Hajdar Sutaj
Falemnderit drejtor Izet a do më u përgjigj. Ok dikush tjetër a kanë lidhur me këtë njoftim, me shtue se më sugjeruar diçka Yllarta Thaqi po e nderuar antarë e kuvend.

Yllarta Thaqi
Faleminderit zotri Orgesi tha se na jemi vetëm për emërtimet dhe riemërimet deri në vitin 2029. A nuk keni mandat me fillu tash? Se ose ke keqkuptim ose diçka tjetër.

Hajdar Sutaj
Falemnderit Orgesit.

Orges Tafilaj
Lista realisht emrave rezervë do vlejë për 10 vitet e ardhshme. Pas 5 vite mund të rishikohet për shkak se po shpresojmë që 1 pjesë e emrave nga lista sa më shumë që të jetë e mundur dhe që i plotësojnë kushtet, do largohet për shkak se rrugët do marrin emërtimet te pjesa 2029 s kisha në lidhje me riemërtimin domethonë deri në atë kohë, pa marrë parasysh se emra t'caktum mund të bëhen pjesë e listës rezervë, nuk kemi të drejtë të vendosim për 1 riemërtim të rrugës.

Hajdar Sutaj
Faleminderit Orges, dikush tjetër. Atëherë falemnderit Orges. Faleminderit kolegë për pyetjet drejtor Izet ata do mu përgjigj pyetjen e Erdoganit per tabela. Ndryshe. Falemnderit atëhere e kalojmë si pikë të rendit dits.

Jemi te. Pika 4

IV.Themelimi i Komiteteve, për Shëndetësi, për Arsim dhe për Kulturë.

E kështu koleg ju kisha lut ju çka jeni shefat e grupeve mernu vesh ka sa antar po doni me kan komisionet edhe nëse keni nevojë me u konsultu për emrat, ka 5, 3 me 2 ose nëse doni më ba 7 duhet 4 me 3. Nëse keni nevojë konsultoni për të 3 komisionet. Ju kisha lutë shefat e grupeve të Subjekteve që jeni këtu. Tash është ora 11 e 4, 11, 10. E propozoni numrin dhe emrat falemnderit 11:10 jemi këtu jo më shumë. Këto mfalni uluni ni minut ta qes nvotim mesa antar po doni me pas numrin. Ke propozimi prej grupit AAK-se është me kan, sa vetë mendoni mi pase aty pi pyes krejt grupet, jon pa pagesë këta. Atëherë e 5 LDK- ja propozon, 5 AAK propozon 5. Atëherë ne e lojmë më 5 antar. Mundem me pas edhe ju nevojitet pak pauzë për mi tregu emrat. 11 10 5 minuta fiks 5 minuta ju lus 5 minuta 11 e 10 në orën e fillojmë seancen. Koleg ju lus mi nxonë, venat e kemi kalu 3 minuta kohën e planifikume. I. Kolegë e kolege. Nëse keni mundësinë mi nxanë vendet. E vazhdojmë piken 4. Çë është themelimi i komiteteve për shëndetësi, arsim dhe kulturë. Fillimisht po e emrojmë, po e bëjmë propozimin e komisionit për shëndetësi. Pi grupit AAK-se mundësisht jepni 3 propozime, Arjan Dobraj e ka fjalen.

Komiteti për Shëndetësi

Arjan Dobraj

Faleminderit kryesues. Në komitetin për shëndetësi propozimet tona janë, si vijon Lulavere Qorraj Selmanaj, Lendita Berisha edhe Afrim Demhasaj. Në komitetin për shëndetësi. Lulavere Çorraj Qorraj Selmanaj, Lendita Berisha dhe Afrim Demhasaj.

Hajdar Sutaj

Falemnderit LDK-ja Hyrije Dobrunaj.

Hyri Dobrunaj

Po kryesues, po e shoh që nuk paska me pas shum ndryshime prej vitit 2021 kur e ke themelu ni komision për shëndetësi pak te grupi aleancën e propozojnë prapë Syl Balaj dhe shpresojmë që kësaj radhe ky komision ka me u takue me punu e me ni her jan taku, kështu që unë shpresoj që ke than me bo xhan e duhur.

Hajdar Sutaj

Faleminderit e prej vetëvendosjes Orges Tafilaj e ka fjalen.

Orges Tafilaj

Për komitetin për shëndetësi e propozoi Faton Selmanaj.

Hajdar Sutaj

Falemnderit Orges atëherë propozimet i kem kështu, nga AAK-ja doktoresha Lulavere Qorraj Selmanaj, Lendita Berisha edhe Afrim Demhasaj nga LDK- ja Syl Balaj edhe nga Vetëvendosja Faton Selmanaj, kush për. A ka kundër a ka abstenim? Konstatoj që mënyrë unanime të pranishme që anëtarët e kuvendit e kanë votu propozimin në fjalë të komitetit për shëndetësi. Kominteti per arsim Arjan Dobraj, antarë të propozuar prej AAK-së .

Komiteti për Arsim

Arjan Dobraj

Po në komitetin për arsim propozojmë këta emra Arjan Dobraj Yllarta Thaçi dhe Floriana Hulaj. Faleminderit.

Hajdar Sutaj

Falemnderit prej LDK-je Hyrije Dobrunaj.

Hyri Dobrunaj

Edhe grupi i LDK së e ka propozimin e vet, mirëpo fillimisht na kishim dashtë si grup me pas raportin e atij komisionit paraprak që e kanë bo ni vëzhgim në shkolla me pa deri ku keni shku me përmbushjen e atyre objektivave që kanë qenë prej atij raportit kalum. Ne propozojmë në Komitetin për arsim, Kadri Tahirukaj.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shum prej Vetëvendosjes, Teuta Neziraj e ka fjalen.

Teuta Neziraj
Atëherë ne për komitetin për arsim e propozojnë Orges Tafilaj.

Hajdar Sutaj
Falëminderit shum, atëherë ne i lexojmë emrat, propozimet e plota, Arjan Dobraj, Yllarta Thaqi, Floriana Hulaj, Kadri Tahirukaj dhe Orges Tafilaj, kush a për. Kundër ska, abstenim ska, konstatoi që kuvendi ne menyr unanime e ka miratuar përbërjen e plotë të komitetit për arsim.

Komiteti për kulturë
Nga grupi AAK Arjan Dobraj e ka fjalen.

Arjan Dobraj
Po në komitetin për kulturë kemi 3 propozime: Armend Loshaj, Leotrim Hadërgjonaj dhe Elmedina Sadikaj.

Hajdar Sutaj
Faleminderit, nga LDK-ja.

Hyri Dobrunaj
Ne komitetin për kulturë, Shkëlqim Tolaj.

Hajdar Sutaj
Falemnderit, Vetëvendosja Orges

Orges Tafilaj
Komiteti për kulturë, ne propozojmë Teuten.

Hajdar Sutaj
Falëminderit shum. atëher ne e kemi përbërjen e plotë të komitetit për kulturë, përbërja: Armend Loshaj, Leotrim Hadergjonaj Elmedinaa Sadikaj, Shkëlqim Tolaj dhe Teuta Neziraj, kush a për, A ka kundër, abstenim ska konstatoj që kuvendi e ka miratuar edhe komitetin për kulturë.

Tash osht pika nr.5
V.Shqyrtimi i kërkesës së Lidhjes së Historianëve Ali Hadri në Deçan,
Ashtu qysh e ka aprovuar me ardhë në diskutim në mbledhjen e kuvendit, Komiteti për politikë e financa në mbledhjen paraprake, por dhe mbledhjen e fundit, jemi dakordu që ta delegojë te kuvendi, me qenë se shuma e kërkuar është vlerë prej 6.509 euro, e cila e kalon mandatin e komitetit? a ka dikush diçka. Falemnderit kush për, A ka kundër? A ka apstenim. Konstatoj që me. E pyeta nuk u lajmru masa ndaj. E kemi e kemi votu këtë kërkesë.
Faleminderit shumë jemi te. Pika 5
V. Të ndryshmet
A ka dikush diçka më thonë. A ka, Vatan Istrefaj, Syla pastaj Hyrija.

Vatan Istrefaj
Faleminderit kryesues, siç po shihet tek pika të ndryshme. Pra, kemi disa kërkesa që janë për të adresuar zbashkut me ju, po siç e shohim, pra pjesëmarrja e ekzekutivit komunal është në gjendje të mjerueshme. Pra sot ku e shohim se 2 drejtor i paskmi këtu dhe drejtorin e arsimit dhe tbujqësisë. Më tmirët i rujt zoti, pra kështu që shumica nuk është kryetari, as drejtor paraprak. Une pata 1 kërkesë për drejtoreshën e shëndetësisë. Po ashtu edhe për drejtorin e shërbimeve publike, po më duket që sot të keni 1 aktivitet partiak më interesant i paska dok ajo pjesë sesa me ardh nkuvend.

Hajdar Sutaj
Njerëz kryesorë të Partisë i ki qetu.

Vatan Istrefaj
Po filloj me pyetjen e kam 1 pyetje rreth qendrës kryesore të mjekësisë familjare në Deçan? Po rreth menaxhimit të saj, ku tanimë e dimë se drejtori paraprak tanime ka dalë në pension. Pra e gzon pensionin dhe sipas 1 akti

nënligjor është dashur që të shpallë konkursi 2 muj para se del drejtori ne pension. Po pse e keni lënë QKMF-ne tani me pa menaxhim apo keni ndonje tendence? Nuk u hapet konkursi. Ne e dimë këtu se ne si kuvend komunal problemi themeluese që kemi festë në dyqan, por edhe pse nuk është drejtoresha, po kërkoni përgjigje kështu ma dinjitoze nga ana juaj. Po ashtu, pasi që diskutuam sot për tabelat dhe emërimin e rrugëve, është 1 kohë e gjatë që bëjnë kërkesë për rinovimin e atyre tabelave, pasi që shumë janë dëmtuar ose nga kushtet atmosferike aksidentale tjera. A ka mundësi drejtor nese nuk a ktu? Nëse nuk mundesh me na jap neve ni përgjigje pse nuk po del tani ni tender për ato tabela me rregullu a po mos edhe ato pare i ka marrë permbarusi dhe nuk a marre me kallzue. Më thoni I ka marrë përmbaruesi, skena. Si pasojë e kësaj, pra edhe kësaj radhe transparencë komunale keni dalë komuna 27, por keni 2 3 pikë. Ma poshtë sikur herën e kaluar kjo kallxon ma mire menaxhimin e juaj.

Hajdar Sutaj
Vatan realisht janë pyetje që i adresohen ekzekutivët. Nuk jam personi kompetent që mund të më dhënë këtë përgjigje. Dikush tjetër thotë Faton edhe Syl Balaj. Megjithatë, pyetjet të cilat i bëni do t'ju përcjellim mënyrë që ti japim përgjigjet.

Sylë Balaj
E kam 1 kërkesë nga këshilli i fshatit isniq. Ne si këshill i fshatit kërkojmë nga komuna, në veçanti nga kryetari Ramosaj dhe drejtori përkatës i drejtorisë së bujqësisë dhe ambientit. Kërkesa është që pasi kompania punëkryese Lika ka fituar tender prej 1,6 milion euro për të ndërtuar kanalet në komisionin. Ne si fshat jemi përshtatur 1 1 paguesit më të mëdhenj. Kemi të drejtë të kërkojmë që nga ky tender të ndahen mjete të mjaftueshme për betonimin e të gjitha kanaleve të cilat janë vitale për ujitjen e tokave pjellore në fshatin tonë urojmë dhe shpresojmë që kësaj radhe të mos jemi të anashkaluar, por kërkesa jonë të merret me seriozitet.

Hajdar Sutaj
Falëminderit shum koleg Sylë, drejtori për bujqësi është këtu, zotëri Rifat Stojkaj e ka fjalën.

Rifat Stojkaj
Falëminderit për fjalën kryesues, përshëndetje të gjithë juve nderum antar të kuvendit komunal që jeni prezent fillimisht e udhëzova, mirë që morëm burime që të kem shëndetin dhe na ruan zoti falemnderit shum ashtu qoftë e saj per kete pyetje se Sylë faleminers e për pyetjen pranë nesh je korrekt me banorët me këshillin e fshatit atje realisht te ne në 1 projekt që kishin fituar nga ministria e bujqësisë, ai projekt është në përfundim nga fshati ku vini ju. Aktiviteti jo ndërtu dikun 5,5 kilometra me kanalet e ujitjes dmth mi pjesë e madhe e fshatit e pronave bujqësore. Atje vetëm tash kanë mundësi që të ujiten ashtu edhe siç duhet ne projektin që është projekt komunal se per kete vijave ose kanaleve të ujitjes. Edhe në këtë projekt projektin komunal është i përfshirë e fshatit isniq me 2 degëzimet e kanaleve të ujitjes famshëm.
Hajdar Sutaj
Falemnderit per pergjigjet. Drejtori Hyrije Dobrunaj e ka fjalën.

Hyri Dobrunaj
Pyetja ime i drejtohet kryetarit komunës. Mirëpo meqenëse ai nuk është këtu, sikur shumë herë që nuk është prezent dhe takimet e asamblesë po i drejtohem drejtorit të DKA- së se edhe ka të bëjë me disa të ashtuquajtura takime informative me gjithë mësimdhënësit e shkollave të Deçanit, xhaja për të njoftuar ata me planin zhvillimor të arsimit komunal, takimet përcaktonin orën 11 me grupe shkollash dhe me njëfarë detyrimit mësimdhënësve për pjesëmarrje. A jeni tvetëdijshëm se me këtë organizim tërësisht pa ndonjë efekt përmbajtje, ju po humbni qindra orë mësim nxënësve të shkollave tona. Çfarë do të shkruajnë mesimdhënësit rubrikat ku shkruhet përmbajtje orës mësimore, apo të evidentohen këto sikur të humbura mësimi apo si do ti arsyetoni këtu arsimin? E keni politizuar çdo segment tjetër arsimin. Po se po bile skajshem, ne ju tërheqim vërejtjen ta ndërprisni këtë trend se mjafte keni degraduar arsimin, madje madje keni shku deri aty sa i keni takuar edhe liderin e juaj me të gjithë mësimdhënësit, me dëshirë dhe pa dëshirë, me detyrim. Kjo praktikë uroj e shpresoj shumë shpejt mos përsëritet.

Hajdar Sutaj
Drejtori Besnik Hulaj fjalën.

Besnik Hulaj

Përshëndetje. Fillimisht informoj se ne kemi 3 takime të ndara me gjitha shkollat e komunës tDeqanit. As nuk humb edhe i kemi nda edhe në shkollat fillore kemi nda 2 grupe jan gjithsej 18 shkolla 9 niher 9 nihere dhe 2 gjimnazet diten e mramt nuk janë takime politike. Janë takime konsultative, e kemi parapa që me konsum AE. Hapun me gjithë dhe për planin zhvillimor komunal të arsimit, i cili është duke u hartuar për momentin. Tjetri takimet iki mor gjitha konkluzionet kritika. Kemi bashkpunu kryesisht me drejtorat të shkollave për përparësi kanë pasur plane zhvilluar me shkollave të tyre. 2 muaj pas pakti qe jem tu u mar me plan zhvillimor tarsimit dhe besoj se fundi e kemi pas edhe si draft në asamble për me kalu. Deri sa I përket vizitës së Haradinajt, ka qenë për homazhe n'Deçan, sikur jeni kan edhe ni pjes e madhe e juvja, Nëse ka pasur diçka politik, gjitha këto takime unë jam i gatshëm dhe në përgjithësi e ka pas. Por dhe homazhe e të gjitha këto takime po nuk ka bujqësore, ka përshëndetur fjalë përshëndetëse .

Hajdar Sutaj
Falemnderit shum Albesa Cacaj Nuk ishte i vëmendshëm në sap ne. Ata përmendin. Lejet mos ta bëjmë tash debat se kshtu ká shkojnë ka zgjedhjet të dimë që TU fol, Albes urdhno fjalen

Albesa Cacaj
Atëherë përshëndetije edhe 1 herë, me mungesë të kryetarit çu potencu ç'e shumicën e kohës ose mbledhje nuk është i pranishëm. Atëherë detyrohemi qe pyetjen t'ia drejtojmë drejtorit të arsimit në komunën e Deçanit, drejtor në mandatin e kaluar asambleja ka miratuar 1 strategji të tillë për periudhën 2019-2022. Kjo po bie se formalisht për vitin 2023 keni punuar me 1 strategji të vjetër. Pas vitit 2019-2022 e kemi rishikuar strategjinë e vjetër. Dhe a keni vërejt se në përqindjen më të madhe ajo nuk është realizuar? Pse po e mashtroni veten dhe mësimdhënësit lidhur me këto të ashtuquajtura takime informuese të cilat i potencoi edhe zonja Hyri? Po ju rikujtojmë se kërkesat vine te komisioni për hartimin e strategjisë dhe në 2 kohë nga drejtorët e shkollave është detyrë e drejtorëve që këto kërkesa paraprakisht ti diskutojmë me organet qeverisëse të shkollave dhe me mësimdhënësit. Prandaj nga kjo del se ata kanë qenë më të informuar më herët të informuar se ju sepse jane formulues të kërkesave. Lëreni të qetë, pra, mësimdhënësit ti realizojnë planet mësimore. Mos ua mohoni nxënësve, mbajtjen e rregullt të mësimit. Ata nuk mund dhe nuk do duhej të vihen në shërbim të politikës suaj. Faleminderit.

Hajdar Sutaj
Faleminderit shum Albesa e paske pas shkrue e paske pas qenis a ka dikush tjetër diçka. Lulavere Qorraj Selmanaj doktoresh. Po Albes gjithqysh. Albesa Cacaj e ka fjalën.

Albesa Cacaj
Çeshtje qe osht për me qesh, faktikisht çështje për me kajt në arsimin që ka komuna e Deçanit. Kështu që kisha lut fillimisht si kryesues i kuvendit, thjesht nivel detyres, pastaj asambleiste. Faleminderit.

Hajdar Sutaj
Faleminderit shum prej teje faleminderit edhe per kshillen Lulavere Qorraj Selmanaj e ka fjalën.

Lulavere Qorraj Selmanaj
Atëherë faleminderit, përshëndetje për të gjithë ju koleg unë po ndërlidh nga pyetjen që u bë pare nga kolegët për drejtor të QKMF-së, pasi që nuk është drejtoresha e drejtoratit për shëndetësi. Unë s'mund t'i japë përgjigje pse nuk u shpall konkursi, mirëpo nuk do të thotë që QKMF ka mbetë pa udhëheqje, përkundrazi punon shumë mire, ashtu si ka punuar gjithherë sepse i ka strukturat udhëheqëse dhe ka zëvendës drejtorin.

Hajdar Sutaj
Faleminderit shumë doktoreshë, e ka fjalën Miftar Ahmetxhekaj apo Blinera. Ok Blinera Lokaj e ka fjalën Miftari pastaj Arjani. Ok kështu tkërkoi falje.Pe respektojmë Blinerën se veq ju ka dhez mikrofoni, pastaj Mon po ta kalojm fjalën ty të kërkoj falje.

Blinera Lokaj
Pajtohem me parafolësit nga grupi i këshilltarëve të LDK, po e theksoj se humbja e qindra orëve të mësimit në këtë fundvit shkollor nuk mund të arsyetohet dhe ky është 1 shqetësim për strukturën e lidhjes demokratike, po ashtu edhe për qytetarët. Po ashtu, kjo hasë në kundërshtim edhe me kështillat e prindërve dhe të nxënësve. Ju keni pas mundësi gjithë këtë ta realizoni pa humbur asnjë orë mësimi, se paku në 2 mënyra, e 1-ra përmes

drejtorëve të shkollave, si dhe e 2-ta keni mundur që dokumentin t'ua dërgoni të gjithë mësimdhënësve në mënyrë elektronike.

Hajdar Sutaj
Faleminderit Blinerë, Mon Selmanaj e ka fjalën.

Mon Selmanaj
Kryesues, Miftar, kërkoj falje. Deri tani ke drejtori i shërbimeve publike në pyetjet i kam dedikuar për te, por megjithate 2 drejtorë këto shpresoj. Pse do ta interpretojnë këto shqetësime edhe të mija edhe të qytetarëve? Njëra prej pyetjeve është që kur do të largohen Trafot, këtë çështje u ngrit disa here në kuvend kur pritet të largohen trafot e KEDS-it, të cilat janë vendosur në trotuaret përgjatë rrugës kryesore. Dhe tjetra. Është dhe hapësirat publike në Qendër të Deçanit janë, ato janë duke keqpërdorur. Rasti më i keq është tek lokalet Tek lokalet ku është stacioni i autobusëve që presin udhëtarët me shku në drejtim të Pejës. Stacioni përballë postës. Ajo pjesë e trotuarit publik shfrytëzohet me padrejtë nga kafiteritë dhe bizneset tjera si tarasë apo vendosje të gjërave afariste, ndërsa nxënësit dhe udhëtarët detyruan të qëndrojnë në rrugë. Madje ka ankesa nga qytetarët se familjarët e tyre dhe nxënësit detyrohen të shkojnë këmbë tek kanali për ta pritur autobusin vetëm e vetëm që t'u shmangen kontakteve me njerëz të shumtë që qëndrojnë të ulur me karrige e tavolina në vendin ku do të duhej të qëndronin ata që presin për autobus, 2 pyetje i pata për drejtorin megjithatë. Shqetësime ju kisha lut kryesues ti përcillni te ekzekutivi. Faleminderit.

Hajdar Sutaj
Faleminderit dhe shqetësime shumë me vend dhe do t'ia përcjellim. Miftar Ahmetxhekaj pastaj Arjani pastaj Yllarta

Miftar Ahmetxhekaj
Adresimi do të jetë për drejtorin Stojkaj, jam i vetëdijshëm që ka investime në raport me kanalet e ujitjes në fshatin Isniq? Tuj pasë parasysh se Isniqi është 1 prej fshatrave të Deçanit dhe veprimtarinë bujqësore ma te madhe, ka shumë cilët zhvillojnë dhe kanalet e ujit. Është 1 farë infrastrukture mbështetëse cilët u ndihmojnë atyre në prodhimtarinë e vet. Megjithatë, në projektin e fundit unë kam 1 pyetje konkrete drejtor u tha 2 degëzime nëse ka mundësi për cilat degëzime bëhet fjalë, a keni 1 shifër të saktë sa është e parapame në këtë projekt kilometra nga fshati Isniq. Dhe nese nuk janë të përcaktuar prioritetet, pyes, a ka mundësi që prioritetet për kanalet te merren nga këshillat e fshatrave nga kryesuest nga fshatarët, për shkak se kush më mirë se sa ata nuk e dinë se cila është, cili kanal ujitës është më me prioritet për të.

Hajdar Sutaj
Falëminderit Miftar drejtori Rifat Stojkaj e ka fjalen

Rifat Stojkaj
Miftar faleminderi për pyetjen, një pjesë e madhe e përgjigjes ju drejtue dhe kolegut të juve ma herët realisht e projektet që kanë përfundu që thashë më herët flitet për diku në 5.5 kilometra betonimi i kanaleve të ujitjes kanë qenë projekte të realizuara në vitin 2018, hartuar në vitin 2018, siç kam thënë më herët, shumicën e kohës jam në teren, jam në bashkëbisedim me fermerë. Edhe këto 2 degëzime ka qenë e imputet more prej qytetarëve. Kërkoj falje që nuk jau dija më atë, por nese nuk gaboj nëse nuk gaboj me shifër, bëhet fjalë për 2 degëzime. Dikund rreth 100.000 euro janë të ndame sa i përket projektit të komunës së Deçanit, por kanalit të ujitjes në drejtim të fshatit.

Hajdar Sutaj
Faleminderit Arjani pastaj Yllarta. Arjan Dobraj e ka fjalen.

Arjan Dobraj
Faleminderit kryesues në fakt kaluan disa tema që me shty temën që e nisi kolegë për punën e DKA-së dhe punën e takimeve. Unë kam qenë personalisht pjesë e takimeve me po besoj me 2, 3 kolegë nga këtu realisht takimet janë mbajt 1 sesion e 30-të të ndara. Edhe osht nuk është në rregull me thënien humb qindra orë, sepse atë ditë që është mbajt takimi orët janë bartë, janë mbart me shkurtesën, mirë thashë dhe nuk është humb, domethënë asnjë orë. Edhe edhe nëse kishin hum potencialisht po thonë se nuk i shikon me shkurtesa dhe nuk ishin mbajtë 2 orët e fundit, prapë nuk i kisha qindra orë po dikund i kisha të gjitha shkollave që kanë marrë pjesë në takim të gjitha shkollave po thonë vetëm nga 2 orë jo më shumë që i bie 2 po 2 orë mësimi shumë e logjikshme. Edhe

për me shtu diçka kësaj pjese. Ky takim për mendim temin dhe për gjithë duhet me qenë i mirëseardhur pse do me qen mirëseardhjen. Nuk besoj që drejtorët e secilës shkollë në bashkëbisedim me kolektivin e vet mundën dot ngarku drejtuar me detyrë që mori pyetje, kërkesa 5 mësimdhënës ku është mundësia shumë e mirë shumë ideale që qato pyetje mu address u ose me kërku në komisionin që e kanë ba planin zhvillimor të arsimit komunal e që ato pyetje ose kërkesa ose paqartësi kemi pas mundësi me i zgjidh, në ditën që u mbajt takimi informues për pikat e planit zhvillimor, I cili u prezantue shumë mirë për cilën punë shfrytëzoj rastin nga këtu mbi përgëzue edhe komisionin dhe nuk mendoj që duhet të më kapte pika e takimit të 3-të sesionin e 3-të kanë qenë duket shkollat gjimnazet, drejtor. Nëse nuk gaboj që ish kryeministri Haradinaj ka qëlluar rastësisht aty për shkak të 1 vizite që ka bo me ditën e dëshmorëve dhe të qendrës rinore, nuk besoj të më marrë që Vetëm pse i ka përshëndetur i ka uruar sukses nuk mendoj që do të marrë edhe me bo politizim të kësaj pjese. Falemnderit.

Hajdar Sutaj
Yllarta Thaqi e ka fjalen, tlutna kolegë. E luta ta nalim ket debat masanej e qartsoni se nuk thanë as najsen ashtu.
Yllarta Thaqi
I unë po naj se çdo pyetje TI bëjmë si lloj interpelance. Jemi kalojmë kot me vet faktin se disa herë kom bo pyetje vetes ku marku përgjigje derisa personat përgjegjës që i referohen nuk janë prezent ju lus ose i propozoi gjithë kolegëve gjitha subjektet politike. Pyetje, ti bajmë me shkrim, ti dorëzohen me shkrim dhe të na mbesin edhe si dëshmi edhe neve po të majme dhe përgjigje çdo pyetjeje krejt pa përgjigje mbeten. Domethan na e zgjasim seancën kote se koti, derisa këto pyetje mbeten vetëm ose procesverbal ose nuk mbesin hiq. Faleminderit për mirëkuptim amo un nuk jam ka shoh të arsyeshme me zgjatë seanca me pyetje të kota, falëminderit shum.

Hajdar Sutaj
Faleminderit shumë dikush tjetër. Po more se veç thash ta përfundon ajo e ka fjalen Hyrija pastaj Vatani. Po a din qysh po du me thonë se është normale, po folim mos ta bëjmë shumë se shkojmë deri pa kufij në debate. Hyrije Dobrunaj pastaj Vatan Istrefaj.

Hyri Dobrunaj
Fillimisht pyetja ime nuk ka qenë fare politike. Ka qenë me qëllim të mirë ajo çka na e kemi popullsi problem dashte me luftu, mirëpo vetë implikimi, edhe shefi i grupit e tregon ecurinë e kësaj. Do të thotë ju e tregoni veten pa ju pyt fare sa i përket kryetarëve të partive politike nesër edhe LDK ja me kon pushtet hiç kryetar i partisë politike s'ka nevojë me ardh në mbledhjet e këshillit arsimit. As me përshëndetë, si shtet kujdeset kryetari i komunës që ju ne raport u për strategjitë që i bani për implementimin e tyre. Mos vijnë fare në përshëndet s'kemi nevojë për politizim të arsimit prej asnjë partie politike.

Hajdar Sutaj
Faleminderit shumë Vatan, Vatan Istrefaj e ka fjalen. Okej po bën?

Vatan Istrefaj
Po kështu falëminderit. E kom edhe ni pyetje shtesë, pra faleminderit qe ma dhe fjalën per sdyti here, pyetja ka të bëjë me inspektoratin e komunës, pra 1 ditë po kaloj rastësisht, po ishte ora 1 e mëngjesit në qendrën e Deçanit dhe aty të Qendra Centrum pra qe i thojm, tek Qendra Centrum ishin bërë disa punë tonë natës duke punuar duke bërë ndërrimin e do kockave të para lokaleve. Aty nuk kam diçka personale, as 1 lokal aty, po vetëm a jini në dijeni ju si ekzekutiv komunal apo si inspektorat i komunës që po bën punime edhe natën dhe a kanë leje ato punime.

Hajdar Sutaj
Shumë pyetje me vend.

Hajdar Sutaj
Asht mirë me pas ket përgjigje se nuk mundet me punu nese skan pas leje a fjalë. Nëse kan pas leje okej. Arijan edhe 1 herë fjalën dhe përfundojmë.

Arjan Dobraj
Ti e din që nuk është e teproj shumë dhe nuk e mar fjalën pa arsye. Nuk nuk është e përfshirë në debate ka ni herë sepse nuk na çojnë asgjëkundi shpeshherë. E implikimi im se ceku zonja nga radhët e LDK së nuk ka

implikime i qëllimshëm se nuk e patën plan realisht më fol po qëllim kryesor kem me e sqaru që mos me kriju turbullina. Sepse qytetaret jan tu na shikue e tu na dëgju dhe del fjala si thonë jashtë kësaj salle dhe merret vesh gabimisht. Ky ishte qëllimi im i vetëm e implikimit, siç e quajti kjo që të mos shkaktohen turbullina, të informohen qytetarët, po mësimdhënësit që na shtojnë dhunën apo disa që edhe ata e dinë që kanë qenë mundemi, pyeti kolegët e asamblesë. Gjithë ata që kanë qenë prezent sa ka qenë kështu siç them unë, apo siç po thonë kolegët nga opozita falëminderit.

Hajdar Sutaj

I faleminderit shumë për kontributin që dhatë në këtë takim, e shpalli të mbyllur këtë mbledhje, shihemi mbledhjet e ardhshme.

DEÇANI

KUVENDI KOMUNAL - DEÇAN

Municipal Assembly of Decan

TRANSKRIPTI

Mbledhja e Kuvendit të Komunës

(Legjislatura e VII , mbledhja e II-të e jashtëzakonshme)
me dt.11.06.2024

DEÇAN

11 Qershor 2024

Transkripti I mbledhjes së II-të të jashtëzakonshme të Kuvendit, dt.11.06.2024

Hajdar Sutaj, kryesues I Kuvendit

I nderuari kryetar i komunës së Deçanit, zotri, Bashkim Ramosaj, nënkryetar, drejtora kolegë, anëtarë të kuvendit, mirë se keni ardhur në Mbledhjen e 2-të jashtëzakonshme për vitin 2024. Në kuvend tkomunës e cila mbahet sot edhe ka ni pikë të rendit të ditës qe është:

1. **shqyrtimi i propozimit të kryetarit të komunës zotri Bashkim Ramosaj dhe marrja e vendimit për shpalljen Qytetar Nderi të Komunës së Deçanit, Doktor Mentor Petrela.**

Fillimisht me lejoni të konstatoj që prej 27 antar te kuvendit 20 janë prezentë, 7 mungojnë, që nënkupton që kuvendi i komunës ka korumin e mjaftueshëm me vazhdu me punimet e kuvendit. Si dhe shqetësimet nga mbledhja e kaluar të disa kolegëve që transmetimi ka qenë me pengesa tmdhaja dhe ju kam drejtu me ni shkresë edhe po i drejtohem edhe këtu publikisht mediumit e cila e ka fituar të drejtën për transmetimin e seancave, të ketë 1 transmetim dinjitoz dhe professional të seancave të kuvendit të mos kenë pengesa dhe mos kenë vanesa. Siç e keni edhe ni letër realisht në 1 dokument prej 2 letrave e para asht kërkesa në të cilën kryetari i komunës, zoti Bashkim Ramosaj, i ka drejtuar anëtarëve të kuvendit për propozimin. Duke u bazuar nenin 58 pika h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, numër 03/L -040 dhe nenit 56 pika 8 e Statutit të Komunës së Deçanit, propozoi që të merrni vendim për shpalljen e doktor Mentor Petrela "Qytetar Nderi" i Komunës së Deçanit, me motivacionin: për kontributin e tij në fushën e shëndetësisë, në veçanti për ndihmën dhe angazhimin e tij ndaj qytetarëve të komunës së Deçanit.

Doktor Mentor Petrela është njëri ndër neurokirurgët më të mirë jo vetëm në shqipëri, por në gjithë botën. Është krenaria e shqiptarëve kudo, jo vetëm mjeku ynë, por i gjithë botës. Doktor Petrela na ka nderuar kudo në botë.

Të nderuar asambleistë, kërkoj nga ju, t'a mbështetni propozimin tonë dhe të na jepni mundësinë që ta nderojmë për gjithë veprimtarinë e tij shkencore profesionale, mbi të gjitha humane. Bashkangjitur keni dhe biografinë e doktor Mentor Petrelës, që besoj që veç i keni lexuar, por gjithsesi është mirë që ta lexojmë së bashku me qenë se bëhet fjala vetëm për ni person dhe bahet fjal vetëm për 1 vendim. Mentor Petrela lindi në Tiranë në vitin 1950, ku mbaroi shkollën fillore dhe të mesme, studimet për mjekësi i kreu në fakultetin e mjekësisë të Universitetit të Tiranës. Në vitin 1973 u diplomua. Studimet specialistike mbaroj në Universitetin René Descartes XI të Parisit, ku u kurorëzua me diplomë në fushën e neurokirorogjise në vitin 1979. Në vitin 1990-1996 ishte shef i shërbimit të Neurologjisë dhe Neurokirurgjisë në qendrën spitalore Nënë Tereza, ndërsa në vitin 1993-1997 Ishte drejtor i përgjithshëm i kësaj qendre spitalore. Ne vitin 1994 është profesor i Neurokirurgjisë të Fakutetit të Mjekësisë të Universitetit të Tiranës. Në vitin 1995-2000 ishte President i Shoqatës Shqiptare të Neurologjisë, ndërsa nga viti 1996 ushtroi funksionin e Shefit të Neurokirurgjisë në Qendrën Spitalore Universitare Nënë Tereza në Tiranë. Ne vitin 1997 zgjidhet President i Shoqatës Shqiptare të Neurokirurgjissë. Në vitin 1999-2002 ishte Dekan i Fakultetit të mjekësisë të Universitetit të Tiranës, ndërsa në vitin 2008-2011 ushtroi funksionin e shefit të Departamentit te Neurologjisë dhe Psikiatrisë.

Nga viti 1992 është anëtar nderi i Shoqatës Franceze të Neurologjisë. Në vitin 1996 mori çmimin "chevalier dans l'Ordre des Palmes Acadëmiques" (" Kalorësi i Urdhrit të Palmës Akademike") nga Kryeministri i Francës, Alain Juppë.

Në konkurs kombëtar për Universitetet e Francës në vitin 1997 në Paris zgjidhet Profesor i Neurokirurgjisë. Prej vitit 1998 eshte antar i Ëorld Federation of Neurological Ssurgery, European Assotiation of Neurological Societes. Ishte anëtar aktiv I Ëorld Academi of of Neurological Ssugery me seli në Vienë, ku mbajti ligjërata. Në cilësi të profesorit të ftuar, professeur invite) ku mbajti ligjërata në Universitetin e Parisit, te Milanos. New-Yorkut, Gjenevës e tjerë.

Në vitin 2014, Presidenti Frances, Francois Holande ia dha dekoraten me prestigjioze të Francës, "Kalorës i Legjionit të Nderit".

Ka botuar punime të shumta shkencore nga fusha neurokirurgjise në revista të njohura shkencore dhe përmbledhje studimesh në vende të ndryshme.

Kjo është një biografi e shkurtër, e cila osht prezantu, i aspektit profesional, studimeve dhe angazhimeve të doktor Mentor Petrelës, të cilën e keni pasë të bashkëngjitur me document, a ka kush diçka më shtua. Falemnderit shum fillimisht dhe si zakonisht në mes grupeve të subjekteve politike, kisha lutë Arjan Dobraj prej AAK me mare fjalën. Nëse keni mundësi regjia me ja kalu fjalen Arjan Dobrës.

Arjan Dobraj

I nderuar Kryetar i Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, i nderuar kryesues Sutaj të nderuar drejtorë të drejtorive. Të nderuar anëtarë koleg asambleist. Në fakt ne të gjithë e njohim kontributin e madh që ka dhënë doktor Mentor Petrela në fushën e neurokirurgjisë. Përgjithësisht në fushën e mjekësisë, gjithë kemi informacione dhe dije për kontributin e tij të madh, siç e thashë, po besojmë edhe po vlerësojmë që ata që e kanë vlerësu edhe analizue me vlerësu si "Qytetar Nderi" të Doktor Mentor Petrelen, e kanë thënë, e

arsyetojmë ose e kanë arsyetuar në bazë të veprimtarisë së tij të madhe në fushën e mjekësisë dhe nuk kemi diçka me shtu si Grup e përkrahim. Falemnderit.

Hajdar Sutaj
Faleminderit Arjan,Miftar Ahmetxhekaj prej grupit të LDK-së.

Miftar Ahmetxhekaj
Faleminderit shume kryesues, përshëndetje kryesues, përshëndetje për të gjithë kolegët, duke ruajtur konsideraten me respektin për kirurgun ne fjalë. Më lejoni që me pak fjalë, mundësisht të kuptohet objektivisht, çmimet zakonisht "Qytetar Nderi" janë çmime të veçanta, ose thënë shkurt, janë çmimi më të lartë që jepet nga komunat përkatëse, për personalitetet të cilët lidhshmërinë me komunitetin përkatëse, e kanë veçantë dhe ligjshmëri, e cila është në dukje është e pashme. Unë sa e pashë në biografinë e tij me keqardhje, nuk lidhet diçka konkretisht me Komunën e Deçanit. Petrela, kirurg i nderum i tejkalon kufijtë komunal, është kirurg me renome, siç kuptohet në Biografinë e tij, une veq ni pyetje pa u keqkuptu, cila është lidhshmëria konkrete me qytetarët me komunën e Deçanit? Unë di ndërhyrje kirurgjike, s'du mu lëshu në at temë. Konkretisht pse nuk është për Pejën, por është për Deçanin? Konkret po e them edhe një here, është çmimi ma i lart qe komunat u epin qytetarë nderi, e cila ka Konkretisht lidhshmëri të ngushtë, lidhshmëri eksplicite me qytetarët e komunitetit caktuar, në parim kryetar nuk jemi kundra absolut, e mbështesim, por megjithatë krijohet një praktikë që Vlefshmëritë e personalitetit të jenë me komunitetin.

Hajdar Sutaj
Falemnderit Miftar, prej Vetvendosjes, Faton Selmanaj.

Faton Selmanaj
Përshëndetje. Faleminderit për fjalën kryesues, edhe nei si grup jemi për, por paraprakisht pata edhe disa pyetje, e kini cekë, Me motivacion për kontributin e tij në fushën e shëndetësisë, në veçanti për ndihmën dhe angazhimin e tij ndaj qytetarëve të Komunës së Deçanit. Sa njerëz të komunës tone i ka ndihmu ky mjek, sa njerëz ka shëru, në çfarë rrethanash, domethan a ka qenë ndihmë humane, apo çfarë lloj ndihme ka qenë kjo? Faleminderit.

Hajdar Sutaj
Falëminderit shumë, Kryetari, Bashkim Ramosaj.

Kryetari, Bashkim Ramosaj
Unë e kam taku Petrelën në fillim të këtij viti, në një aktivitet që është mbajtë në Tiranë, aktivitet I cili është mbajtë nga një bashkëqytetar I joni I cili jeton në Amerikë, dhe debate për Petrelën ka fillu në legjislaturën e kaluar, që me e shpallë qytetar nderi. Arsyeja pse, ky personalisht si mjek e ka një dashni nër këtë qytet, për shkak të ndjeshmërisë dhe për shkak të lidhjeve që I ka me 2 a 3 persona. Dhe po ashtu, përpos shkencës, perpos zotësisë qe ka, për pos humanitetit çe ka, në shumicën e rasteve të trajtimit të qytetarëve të Deçanit qe jan të shumtë ne numer, ky personalisht nuk është paguar, është tjetër gjë spitali, agjensioni I cili I bënë këto adresime kur e thirë ni ekip të mjekëve, e ky ka qenë gjithmonë i gatshëm edhe me udhëtu dhe e ka thënë edhe me zë të lartë që vi për Shkak se eshte qytetar i Deçanit, e ka ni respekt të tillë për këtë zonë nuk e di krejt arsye pse ka ket respect, mka ardh keq edhe me degju ose ska pas koh me ma spjegu kët pjesë, mirëpo të Deçani për të personalisht është tepër tepër e veçantë për shkak të historisë për shkak të traditës që ka ky qytet.Nuk kemi mujt me bo në asamblenë e kaluar për shkak të disa procedurave te cilat është dashtë me I tejkalu, e që na me marrë të drejtën mos me gabu në këtë drejtim. Unë ju ftoj të gjithë juve mi përkrahë këtë propozim, operacioni i fundit që u bëri është ni bashkë qytetar tonin që është ni burrë i zoti dhe i ndershëm dhe ka ix raste tjera që ky ka bo operacione të çfarëdo lloj kategorie të njerëzve t'Deçanit, ka mjaftu me pasë sinkronizimin qytetar I Deçanit për të. Këto gjanat tjera jan më shumë të aspektit politik, të aspektit të përfaqësimit të tij, që ky mundet me e prezantu në çfarëdo niveli qoftë dhe neve na Shkon në shkon tepër për nderë me pasë "Qytetar Nderi" të Komunës sp Deçanit. Për shkak të zotësisë tina dhe për shkak të aspektit profesional, e sidomos për shkak të 5-6 shtete, ku ka ndikim tepër të madh.

Speaker 1
Falemnderit dikush tjetër a ka diçka. Po, Faton Selmanaj.

Faton Selmanaj
Faleminderit kryesues. Kryetar, në asnjë moment nuk e kontestova as dijen, asgje rreth figurës e personalitetit të dr.Petrelës,.por e pashë të arsyeshme ti bëj këto pyetje, në çfarë rrethanash jan nimu kta njerëz dhe përgjigja ishte e duhur dhe korrekte, përndryshe parimisht jemi pro këtij propozimi.

Kryesuesi

Faleminderit shume Faton, dikush tjetër. Atehere e qes në votim propozimin e kryetarit që Kuvendi i Komunës të merr vendim për shpalljen "Qytetar Nderi" të Komunës së Deçanit, Doktor, Mentor Petrela. Kush është përë. Abstenim ska, kundër ska, konstatoi që në mënyrë unanime nga gjithsej 20 anëntar të kuvendit, të pranishëm të 20 kanë votu për edhe nga sot doktor Mentor Petrela është "Qytetar Nderi" i Deçanit. Titull të cilën do ta ndajmë në seancën solemne që mbahet për 25 vjetorin e çlirimit të Deçanit, e që do të njoftohi domethonë sot me ftesën.Faleminderit shumë, mirë u takofshim ne mbledhjet tjera.